

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. No. 04/2011
23 Prill 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e Eulex-it Katja Dominik si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtari i Eulex-it Andrew Hatton dhe Gjyqtari i Eulex-it Nikolay Entchev anëtarë, me pjesëmarrjen e Kshilltares Ligjore të Eulex-it Jana Bozović si Procesmbajtëse, në lëndën penale kundër **Albano RUGOVA** dhe **Eljon BEQIRI**, që të dy të akuzuar për kryerjen e veprës penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229 para. 4 pika 1 lidhur me para. 2, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në bashk-kryerje (Neni 23 i KPK),

Sipas aktakuzës së datës 30 Nëntor 2011 dhe të parashtuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë më 1 Dhjetor 2011, siç konfirmohet me Aktvendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës të datës 21 Janar 2011,

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 19, 20 dhe 23 Prill 2012, në prani të Prokurorit të Eulex-it Philippe Bauduin, të Akuzuarëve Rugova dhe Beqiri dhe të Avokatëve të tyre Mbrojtës Betim Shala dhe Mahmut Halimi, pas këshillimit dhe votimit të Trupit Gjykues 23 Prill 2012,

Në përputhje me Nenin 392 para. (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) shpallë publikisht dhe në prani të të gjitha palëve të lartcekura këtë

AKTGJYKIM



I Akuzuari

(1) **Albano RUGOVA**, i biri i Idriz dhe Hajrije Rugovës, mbiemri i vajzërisë së nënës Buqaj, i lindur më 04 Shtator 1971 në Pejë, Shqiptar i Kosovës me banim të përhershëm në rrugën Nëna Terezë 121, Peje, shkollën e mesme të kryer, i papunë, pa të ardhura, i pamartuar, dy fëmij, i cili është në paraburgim që nga data 15 korrik 2010, është

FAJTOR

për kryerjen e veprës penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229 para. 4 pika 1 e KPK, lidhur me para. 2, të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në bashkryerje (Neni 23 i KPK),

dhe prandaj

DËNOHET

me 5 (pesë) vjet burgim dhe me gjobë prej 500,00 Euro. Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në kohën e dënimit me burg nga data 15 Korrik 2010 deri sa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë sipas Nenit 73 Para. (1) i KPK. Gjoha duhet të paguhet brenda afatit prej tre muajsh nga data kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë sipas Nenit 39 Para. (2) i KPK.

(2) **Eljon BEQIRI**, i biri i Bernardin dhe Mimoza Beqirit, mbiemri i vajzërisë së nënës Mlika, i lindur 21 Gusht 1982 në Lezhë/Shqipëri, shtetas i Shqipërisë me banim të përhershëm në lagjen Beslidhja, Lezhë, Shqipëri, punëtor ndërtimi, i martuar, dy fëmijë, shkollën fillore të kryer, i cili është në paraburgim që nga data 15 korrik 2010, është

FAJTOR

për kryerjen e veprës penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229 para. 4 pika 1 e KPK, lidhur me para. (2), të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në bashkryerje sipas Nenit 23 të KPK, , dhe prandaj



DËNOHET

me 6 (gjashtë) vjet burgim dhe me gjobë prej 500,00 Euro. Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në kohën e dënimit me burg nga data 15 Korrik 2010 deri sa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë sipas Nenit 73 Para. (1) i KPK. Gjoha duhet të paguhet brenda afatit prej tre muajsh nga data kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë sipas Nenit 39 Para. (2) i KPK.

Gjithashtu, sipas Nenit 229 Para. (5) i KPK, Substancat e sekuestruara Narkotoke që gjinden në katër qese të plastikës dhe në tri qese të letrës në peshë të përgjithshme neto prej 44,77 kg, do të konfiskohen. Ato duhet të asgjësohen pasi Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Sipas Nenit 60 Para. (1) i KPK, automjeti Cadillac ESC, me ngjyrë të kaltërt të bylltë, me numër shasie 1GYFK63857R349146, me targa DPD 1288, i regjistruar në Shtetin e Neë York-ut, Shtetet e Bashkuara, do të konfiskohet.

Sipas Nenit 102 Para. (1) dhe Para. (3) të KPPK, të Akuzuarit obligohen që bashkarisht dhe veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës penale. Secili i Akuzuar do të paguaj nga 250 (dy qind e pesëdhjetë) Euro në emër të shumës së caktuar.

Sepse: Më 15 Korrik 2010 rreth orës 17.00, që të dy të Akuzuarit janë nisur nga Komuna e Skenderajt me veturën e Beqirit të tipit Cadillac, të cilën e ngiste Rugova, me qëllim që të sillnin 44.77 kg Marihuanë në Mitrovicë ku është dashur që të shpërndahet dhe të shitet, siç kishin për qëllim dy të Akuzuarit. Identiteti i personave që ia kishin dorëzuar marihuanën të Akuzuarit Rugova te Hotel Thana afër Klinës, dhe i personave tjerë që po i prisnin ata në Mitrovicë, ka mbetur i paqartë. As Rugova dhe as Beqiri nuk kishin autorizim që të mirreshin në këtë mënyrë me substanca narkotike, siç ishin në dijeni. Marihuana kishte qenë e paketuar në katër qese të mëdha plastike dhe kishte qenë e vendosur në ulëset e prapme të veturës. Këto qese ishin vërejtur dhe identifikuar si mallra



të mundshme kontrabande nga dëshmitarët Lanaj dhe Mangjoll, që të dy officer policie, gjatë një kontrolli afër fshatit Mikushnicë. Ata u kishin thënë të Akuzuarëve që ta ngasin veturën para tyre deri në stacionin policor në Skenderaj për hetime të mëtejme dhe i kishin thënë Beqirit ta ngiste veturën atje. Pasiqë të akuzuarit nuk kishin dashur që droga të gjindet nga policia atje, Beqiri e kishte shpejtuar veturën dhe ishte larguar nga vetura përcjellëse e policisë dhe rreth 870 metra kur kishin qenë në një rrugë me kthesa për në fshatin Prekaz i Eperm, kur vetura përcjellëse e policisë nuk kishte mundur ti shihte më për shkak të shpejtësisë së madhe të Cadillac-it, Rugova kishte hedhur të gjitha qeset e plastikës nga vetura një nga një. Atje ato ishin gjetur dhe sekuestruar nga një njësi tjetër e Policisë së Kosovës. Marihuana dhe Cadillac-u ishin konfiskuar përkohësisht.

Duke vepruar kështu, që të dy të Akuzuarit kanë kryer në bashk-kryerje (Neni 23 i KPK) dhe janë penalisht përgjegjës për veprimin e lartcekur kriminal Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në kundërshtim me Nenin 229 para. 4 pika 1 e KPK, lidhur me para. (2), të Kodit Penal të Kosovës (KPK).



Kryetaria e Trupit Gjykses

Katja Dominik

Këshillë Juridike:

Ankesa duhet të paralajmrohet brenda 8 ditësh nga data e shpalljes së këtij aktgjykimi dhe duhet të parashtrahet në gjykatën e shkallës së parë, sipas Nenit 398 Para. (1) të KPPK. Personat e autorizuar mund të parashtrajnë ankesë në form të shkruar kundër këtij aktgjykimi, përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda afatit prej pesëmbdhjetë ditësh nga data e marrjes së një kopje të aktgjykimit.